



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 296/5 _prot.

Tiranë, më 07 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 185 , datë 07 . 08 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 37 Regj., datë 12.02.2025, paraqitur nga znj. W. H³ kundër Kopshtit Ndërkulturor, Shkodër⁴, në të cilën pretendon diskriminimin të djalit të saj të mitur E. H, për shkak të “*identitetit gjinor të supozuar*”, të djalit të saj, “*pamjes së jashtme të tij*” dhe “*përgjegjësisë prindërore*”⁵.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ Përfaqësuar para KMD-së nga Av. D. N, bazuar në Deklaratën “Autorizim për përfaqësim ligjor”, datë 18.02.2025, të znj. H.

⁴ Sipas emërtesës në Certifikatën e Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, identifikohet si “Qendra Multifunkionale Nërkulturore Shkodër”.

⁵ Pala ankuese ka hequr dorë nga ky shkak, nëpërmjet kërkesës me e-mail, depozituar në dosjen pranë KMD-së me datë 23.07.2025 dhe ka shprehur vullnetin të vijojë shqyrtimin e ankesës mbi shkakun e identitetit gjinor të perceptuar, të fëmijës E. H.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës së znj. H, në mes të tjerash parashtrohet se: “Fëmija E. H, me ditëlindje 30.01.2021, lindur në Oklahoma të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, jeton në Shkodër, Shqipëri së bashku me nënën W. J. H, gjithashtu shtetase amerikane.

Nga Qershori 2024, fëmija E. H ka frekuentuar Kopshtin Ndërkulturor, Shkodër, subjekt të cilit i drejtohet kjo ankesë për diskriminim.

Pas një periudhe mësimi 8 mujore në Kopsht, në datën 05.01.2025, nëna e fëmijës, W. J. H, mes grupit të Kopshtit në Whatsapp ka lajmëruar mësuesit, prindërit e fëmijëve dhe drejtuesit e Kopshtit, se do të organizonte një festë me rastin e ditëlindjes së E, në datën 30 Janar 2025, në një ambient të ndryshëm nga ai i Kopshtit, pas orarit mësimor, ku të gjithë ishin të ftuar.

Në ftesën e ditëlindjes, nëna e E, kishte përcaktuar se tema do të ishte: “Piratët dhe Zanat”, prandaj nëse dëshironin, fëmijët mund të vishnin një kostum të tillë në festë.

Fëmija E. H, seksi i të cilit në dokumentat e identifikimit është “mashkull”, kishte vendosur që në festën e ditëlindjes të vishte një kostum zane, dëshirë që e kishte ndarë me nënën, e cila ja kishte blerë kostumin dhe po merrej me organizimin e festës. Entuziast për festën e ditëlindjes, E e kishte ndarë këtë fakt në Kopsht me fëmijët e tjerë dhe stafin.

Në datën 30.01.2025, nëna e Er, merr një mesazh, i cili është pasuar edhe nga një telefonatë, nga K. K, themeluese e Kopshtit, gjatë së cilës (pasi znj. H i konfirmoi znj. K, se E do të vishej si zanë në festën e ditëlindjes së tij), u debatua mes tyre, ku znj. K i tha nënës së E se, nëse kjo do të ndodhte E nuk mund të shkonte më në Kopshtin Ndërkulturor.

Pas datës 30 Janar, ditëlindjes së E, K e hoqi W edhe nga grupi i Whatsapp-it që kishte me prindërit e tjerë të fëmijëve të Kopshtit, duke e bërë shumë të qartë faktin që i kishte konfirmuar më parë në telefon, se E, nuk duhet të shkonte më në Kopsht. Prej datës 31 Janar 2025, E nuk e frekuenton më Kopshtin Ndërkulturor Shkodër”.

Subjekti ankues, pretendon se përjashtimi i një fëmije nga kopshti, për shkak të veshjes së tij gjatë një feste private, jo vetëm që përbën një rast diskriminimi të hapur, por gjithashtu cenon të drejtën e tij për arsim dhe mirëqenie psikologjike, duke treguar se interesi më i lartë i fëmijës në këtë rast, nuk është marrë në konsideratë dhe as nuk është parë me prioritet nga Drejtuesja e Kopshtit.

Subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri: “Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë në fushën e arsimit, ndaj E, për shkaqet e pretenduara, si dhe detyrimin e subjektit nga i cili vjen diskriminimi, të kërkojë falje ndaj E dhe nënës së tij dhe vendosjen e masave me natyrë sanksionesh në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore”.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar

në nenin 32, pika 1, germa a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 296/1 prot., datë 24.02.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Qendra Multifunkionale Ndërkulturore Shkodër, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Në vijim, nëpërmjet shkresës datë 05.03.2025 (protokolluar me Tonën me nr. 296/2 prot., datë 07.03.2025), Kopshti, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke parashtruar si vijon:

“Ne e mohojmë plotësisht pretendimin e ngritur nga W. H para Komisionerit. E. H hyri në Institucionin tonë me datë 03.07.2024. U bë e qartë që nga fillimi se ai kishte vështirësi në sjellje dhe nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në programin e rregullt. Ai ishte agresiv ndaj fëmijëve të

tjerë, shkatërroi qëllimisht pasurinë e institucionit, përshtyu stafin, hodhi ushqim dhe shumë më tepër. Prandaj, nëna, W. H u informua se E mund të merrte pjesë vetëm me një asistent personal që është përgjegjës ekskluzivisht për të. Nëna ra dakord dhe angazhoi një asistent me shpenzimet e saj.

Që në fillim të pranimit të E, sjellja e tij dhe ndikimi në ngarkesën tonë të punës, ofruan arsye të mjaftueshme për të ndërprerë marrëdhënien kontraktuale me nënën. Këto arsye nuk kishin asnjë lidhje me gjininë e E, pasi fëmija u pranua si djalë dhe kjo temë nuk ishte diskutuar aspak në atë kohë. Megjithatë, meqenëse administrata supozoi se nëna ishte prind i vetëm, dhe për shkak se administrata ishte e shqetësuar për zhvillimin e E, si dhe për faktin që nëna pranoi të bashkëpunonte, ajo u përmbajt nga ndërprerja e marrëveshjes dhe punoi në mënyrë intensive, përtej kufijve të zakonshëm, me të dy, nënën dhe fëmijën.

Drejtoresha ishte pjesë e dy grupeve të ndryshme të bisedës me W. H dhe asistentët e E, si dhe në kontakt të drejtpërdrejtë e të vazhdueshëm me znj. H.

Diskutimet zhvilloheshin pothuajse çdo ditë, shumë herë jashtë orarit të rregullt të punës, rreth sjelljes së E dhe si mund të përmirësohej ai. Ky komunikim intensiv, përtej nivelit të zakonshëm, ndodhi para, gjatë dhe pas “ndryshimit të seksit” të fëmijës.

Për këtë arsye, pretendimi se nuk na ka interesuar fëmija është i gabuar.

Rreth gushtit/shtatorit 2024, fëmija E, i cili ishte 3 (tre) vjeç në atë kohë, pretendoi se ishte vajzë (sms i datës 21.08.2024). Pas një periudhe të shkurtër, nëna e fëmijës pranoi këtë kërkesë dhe u dha instruksione stafit të Kopshtit që të mos e quajnë E si djalë ose të përdorin përemrat “he/his⁶”. Që nga ajo kohë, nëna ka filluar gjithnjë e më shumë të quajë E si një vajzë, duke përdorur përemrat “she/her⁷”.

Që atëherë administrata është përpjekur të balancojë nevojat e E dhe nënës së tij me ato të fëmijëve të tjerë dhe prindërve të tyre. Administrata, për këtë arsye vendosi që t’i drejtohet E me emër, pa përdorur asnjë përemër. Megjithatë, ajo gjithashtu i bëri të qartë nënës se, në një institucion për fëmijë nga 3 deri në 6 vjeç, nuk është vendi i duhur për një diskutim mbi ndryshimin e identitetit të seksit. Administrata ishte e informuar për identitetin gjinor të fëmijës, para festës së përmendur të ditëlindjes dhe nuk e përdori këtë si një arsye për të dhënë një pushim nga puna. Përkundrazi, u shqetësua që fëmija, i cili tashmë kishte vështirësi për shkak të sjelljes agresive dhe pengesës gjuhësore (sepse ai flet vetëm anglisht) tani kishte dhe një faktor tjetër që mund ta bënte më të vështirë përfshirjen shoqërore. E gjitha kjo mund të shihet qartë në diskutimet e shumta në grupe të ndryshme Whatsapp. Për këtë arsye, pretendimi për diskriminim është i pabazuar.

⁶ Refreuar përemrave (të gjinisë mashkullore) në gjuhën shqipe: Ai/atij

⁷ Referuar përmemrave (të gjinisë femërore) në gjuhën shqipe: Ajo/asaj

Po ashtu, nuk është e vërtetë se E iu mohua pjesëmarrja e mëtejshme në institucion, për shkak të veshjes së tij si një zanë, në festën e ditëlindjes të tij, me 30 janar 2025. Administrata nuk ka dhënë kurrë një pushim nga puna, as gojarisht, as me shkrim. Pretendimi se: “K i tha nënës së fëmijës së, nëse kjo do të ndodhte, E nuk mund të shkonte më në Kopshtin Ndërkulturor” është i gabuar. Përkundrazi, administrata dhe drejtuesja shprehën vazhdimisht shqetësim për mirëqenien e fëmijës, dëshmuar edhe sms që vetë ankuesja e ka paraqitur si provë, ku thuhet: “Shqetësimi im ishte për E, që po ekspozon fëmijën tënd”.

Siç pritej, një ditë pas festës së ditëlindjes, disa prindër që morën pjesë shprehën shqetësimin se në institucion po ndodhte një seksualizim i parakohshëm i fëmijëve. Ata ishin shumë të qartë që nuk dëshironin që fëmijët e tyre të ngatërroheshin në lidhje me identitetin e tyre. Në një institucion me vetëm 25 fëmijë, është tashmë ekonomikisht shkatërruese nëse largohen vetëm pesë fëmijë njëherësh.

Në këtë kontekst, është gjithashtu e pasaktë të thuhet se, administrata ka detyrimin të informojë prindërit e tjerë për të drejtën e fëmijës për t’u shprehur si zanë⁸, sepse:

- Nuk bëhej fjalë vetëm për faktin që fëmija, E, ishte veshur si zanë në një festë ditëlindjeje, por për një tranzicion të plotë gjinor të një fëmije të vogël;
- Siç e di çdo shqiptar, në një mjedis konservator si Shkodra/Zdrallë, kjo nuk është vetëm një çështje delikate, por një tabu absolute.

Si mund të jetë përgjegjësia e një institucioni të vogël privat, të thyjë këtë tabu shoqërore me koston e ekzistencës së tij? Për më tepër, administrata vetë nuk është shqiptare, por austriake dhe është përpjekur me muaj të tërë të balancojë këtë çështje, midis gruas amerikane, H, dhe mjedisit shkodran.

Po ashtu, nuk është e vërtetë që u ndalua stafi i institucionit të merrte pjesë në festën e ditëlindjes. Në fakt, mësuesja kryesore ishte e pranishme.

Nuk është e vërtetë që festa e ditëlindjes ishte një ngjarje krejt private, pasi ftesat ishin shpërndarë përmes grupit të prindërve në Whatsapp. Si pasojë, shumica e pjesëmarrësve ishin fëmijë nga institucioni (12 fëmijë nga institucioni, bashkë me 2-3 fëmijë të panjohur për ne). Prindërit dhe anëtarët e stafit të pranishëm mund ta konfirmojnë këtë fakt.

Ankuesja ishte plotësisht e vetëdijshme se prezantimi i fëmijës, E, në festën e ditëlindjes me një kostum perëndeshe femër, para shumicës së prindërve të tjerë, paraqiste një kërcënim ekzistencial për institucionin tonë të vogël dhe se një prezantim i tillë mund të ishte i dëmshëm për vetë fëmijën.

⁸ Citim i palës ankuese: “Në rastin konkret, drejtuesja e institucionit jo vetëm që nuk ka marrë asnjë masë për të informuar prindërit që pretendon se i kanë shprehur shqetësim mbi të drejtën e E për t’u shprehur ashtu siç dëshiron, brenda dhe jashtë institucionit arsimor, por është edhe iniciatore e diskriminimit të drejtpërdrejtë me veprime aktive, duke mos e pranuar më në institucion, sepse u vesh si zanë në ditëlindjen e tij. (fq.7, e ankesës).

Gjatë muajve të mëpasshëm, znj. H e kishte pranuar këtë dhe kishte rënë dakord që të mos e dërgonte E në Kopsht me rroba vajze. Në një mesazh të datës 25 nëntor 2024, znj. H i shkruan K. K (drejtuese e Kopshtit): “Përshëndetje! Nuk dua të krijoj probleme më shumë me prindërit, kështu që, nëse ndonjë fëmijë i tregon perindërve për fustanin e E, dhe ata shqetësohen, thjesht më thuaj dhe nuk do të bëjmë. Do t’i them se nuk lejohet. Ose ndoshta mund t’u thuash atyre se unë i thashë asja jo, por ajo e bëri gjithses. Lol. Çfarëdo që të nevojitet për të mbajtur marrëdhëniet mirë. Nuk e d i- nuk dua të them çfarë të thuash, por jam e kujdesshme që të ms krijoj ndonjë problem me prindërit. Thjesht më njofto”.

Në një mesazh nga znj. H më 25 nëntor 2024, në grupin me K. K dhe asistenten e saj E, shkruhej:

“Doja thjesht të përmbledh atë që kam folur me K sot. Ajo nuk do që ai të veshë fustanin në shkollë, sepse e bën temën e shumë një diskutim dhe mund të ngatërrojë fëmijët dhe të shqetësojë prindërit. Pra, unë do të flas me të, për të gjitha arsyet se pse nuk duhet të veshë fustan në shkollë (është e vështirë të ngjitesh në pemë, nuk mund të vraposh mirë...etj), por K ka miratur për unazat, varëset dhe getat që i pëlqejnë të veshë bnë dimër, kështu që ai mund të shprehë atë në këtë mënyrë, pa shkaktuar shumë probleme.

Në Shkodër e di që kjo temë nuk është aq normale si në pjesë të tjera të botës, kështu që po përpiqem të balancoj nevojat e E për t’u shprehur, me pritshmëritë shoqërore këtu. Po ashtu, E, le të përpiqemi të jemi sa më neutralë në lidhje me gjininë në diskutimet para tij (E). Dhe nëse ai thotë se është vajzë, thuaj “Ok” dhe vijoni më tej, nuk ka nevojë të jetë një debat se diskutim. Po ashtu, kur flisni para të tjerëve, thjesht thuaj “E kjo” ose “E ajo”. Unë përpiqem ta bëj këtë që ai të mos shqetësohet për përemrat dhe të mos ngatërrojë askënd ose të shkaktojë probleme me fëmijët e tjerë që mund të mos jenë të vetëdijshëm për këto gjëra ose që kanë prindër që nuk janë të hapur ose mbështetës për këtë. Më njoftoni nëse ka ndonjëherë më shumë probleme ose diskutime për këtë, në mënyrë që ta menaxhojmë së bashku. Ju lutem, mos hezitoni të përmendni nëse kam harruar ndonjë gjë @ Qendra Ndërkulturore. Faleminderit për ndihmën dhe mbështetjen për E. Ju vlerësoj!”

Dhe një mesazh i datës 5 dhjetor 2024, pasi znj. H tha se ishte konsultuar me një psikolog amerikan të zgjedhur nga ajo dh ka ndjekur rekomandimin e tij, i cili i kishte thënë se: “Thjesht të jeni të respektueshëm për atë që E ju thotë se ndjen brenda vetes dhe mos debato, dhe mos i kushtoni më shumë vëmendje sesa është e nevojshme.”

Këto mesazhe tregojnë qartë se, si znj. H, në koordinim me K. K, ranë dakord ta trajtojnë çështjen në një mënyrë të balancuar për të plotësuar nevojat e fëmijës E, si dhe nevojat e fëmijëve të tjerë dhe të mjedisit shoqëror. Më datë 5 dhjetor 2024, znj. H demostroi besimin që kishte tek administrata, kur shprehet se: “Faleminderit! Ndër personat e vetëm që u besoj për t’u kujdesur për E, je ti (asistentja r), motra jote dhe K.

Megjithatë, znj. H vendosi ta prezantojë fëmijën e saj, E, me një kostum zane në festën e ditëlindjes, më 30 janar 2025. Gjithashtu, ka mundësi që ajo të mos e kishte ndatë këtë plan me administratën,

sepse: 1. Gjatë një bisede me K, znj. H e pyeti vazhdimisht si ishte informuar administrata për kostumin dhe gjithashtu pyeti prindërit e tjetër nëse ata kishin “zbuluar” diçka. 2. Në ankimin e saj, znj. H pranon se, informacioni për kostumin ka vajtur tek administrata përmes fëmijës së saj, pasi E e kishte ndarë këtë fakt në Kopsht me fëmijët e tjerë dhe stafin.

Znj. H e dinte që kjo çështje mund të ndeshej me keqkuptime nga fëmijët dhe prindërit dhe gjithsesi planifikoi, pa e konsultuar paraprakisht, të sjellë fëmijën E, me rroba vajze në një festë ditëlindjeje ku shumica e pjesëmarrësve ishin anëtarë të të institucionit. Mund të supozojmë se ajo kishte qëllime të dëmshme dhe shkatërruese ndaj institucionit dhe fëmijëve të tjerë.

Ky fakt, së bashku me faktin se znj. H, demostroi një sjellje të parregullt gjatë bisedës telefonike me K. K, ngriti shqetësime që znj. H mund ta përdorë grupin e prindërve në Whatsapp për të shkaktuar dëme të tjera, dhe për këtë shkak, ajo u hoq të nesërmen nga administrata, nga grupi i prindërve në Whatsapp.

Megjithatë, grupi i Whatsapp nuk ka ndikim në kontratën që Kopshti ka me ankuesen. Nuk ka të drejta kontraktuale për prindërit që të përfshihen në grupin e prindërve në Whatsapp. Heqja nga ky grup kishte për qëllim që njëherësh t’i linte kohë asaj të vlerësonte me qetësi situatën.

Në kushtet kur znj. H vetë e informoi mësuesen tonë kryesore më 31 janar 2025, se do të dërgonte dikë për të marrë sendet personale të fëmijës, administrata supozoi se znj. H nuk dëshironte më ta sillte fëmijën e saj E, në institucionin tonë.

Për më tepër, kishte situata që në muajt e mëparshëm të kësaj ngjarjeje që na bëjnë të besojmë se znj. H kishte qëllime shkatërruese karshi institucionit. Për shembull, znj. H na kishte informuar se E e kishte të ndaluar të hante sheqer (gjë që e kishin zbuluar para se të vinin në Shqipëri) dhe që ne të mos i jepnin ushqime me sheqer, pasi kur i ha, sëmuret. Stafi e ndoqi këtë udhëzim, edhe pse solli një ngarkesë shtesë pasi fëmija shpesh refuzonte ëmbëlsirat alternative pa sheqer. Pavarësisht kësaj, disa dëshmitarë e kishin parë znj. H, duke i dhënë fëmijës së saj ëmbëlsira jashtë hyrjes së institucionit. Këtë gjë e kishte bërë edhe në festa të tjera të ditëlindjeve të fëmijëve në Kopsht e po ashtu edhe në festën e E.

Kjo do të thotë që, znj. H ka trilluar një sëmundje për të ngarkuar institucionin me punë shtesë, ose në rast të kundërt ajo nuk e merr seriozisht shëndetin e fëmijës së saj.

Duke përmbledhur gjithë sa më sipër, mund të thuhet se, pavarësisht vështirësive në bashkëpunim me nënën e fëmijës, pavarësisht sjelljes agresive të fëmijës E, dhe pavarësisht kërkesës së nënës së tij për ta quajtur fëmijën E si vajzë, nga drejtuesi i Kopshtit dhe gjithë stafi i tij, janë bërë përpjekje të jashtëzakonshme për të siguruar mirëqenien e fëmijës. Njëkohësisht, iu bë e qartë znj. H, se, një institucion për fëmijë nga mosha 3 (tre) - 6 (gjashtë) vjeç, nuk ishte vendi i duhur për një diskutim rreth ndryshimeve të identitetit gjinor dhe se, mjedisi shoqëror në Shkodër e sheh kështu. Në këto kushte, Kopshti ishte në presion të jashtëzakonshëm për të gjetur një zgjidhje që të kënaqte të gjithë.

Mendojmë se ka ndodhur e kundërta e asaj që pretendon znj. H, sepse nga sjelljet e E janë shkaktuar probleme të mëdha tek të gjithë fëmijët e tjerë, fakt i cili na është komunikuar si shqetësim i madh nga prindërit e tyre.

Në kontekstin logjik dhe njerëzor, ne na është shkaktuar një dëm në punë, si pasojë e pakënaqësisë së prindërve të tjerë për sjelljen jo vetëm agresive të E, por dhe të përpjekjeve të znj. H për të ndryshuar identitetin seksual (nga djalë në vajzë) të fëmijës.

Këto veprime kanë shkaktuar konfuzion të fëmijëve të tjerë, duke i ngatërruar rreth faktit nëse E ato e kishin shok apo shoqe.

Mendojmë se znj. H ka vepruar me keqdashje ndaj institucionit tonë, por gjithashtu duke edukuar jo drejt fëmijën e saj E, ka ndikuar për pasojë dhe tek fëmijët e tjerë në Kopsht.

Përfundimisht nuk ekziston asnjë diskriminim ndaj saj apo fëmijës, por mendojmë se jemi ne të diskriminuar nga sjellja dhe veprimet e znj. H”

2. Ne vijim te procedures se shqyrtimit te ankesës, si dhe ne zbatim te parimit te barazise së armëve për një proces të drejtë e të paanshem, nëpërmjet e-mailit datë 11.03.2025, përfaqësueses ligjore të subjektit ankues i janë dërguar për njohje parashtrimet e depozituara nga ana e Kopshtit.
- Nëpërmjet e-mailit datë 18.03.2025, drejtuar Komisionerit, përfaqësuesja e subjektit ankues ka dërguar bashkëlidhur prapësimet përkatëse, të cilat janë analizuar dhe konsideruar në arsyetimin vijues të kësaj vendimi.
3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 296/3 prot., datë 02.05.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve u është bërë e ditur se mund të depozitojnë gjatë seancës dëgjimore. fakte e prova që mbështesin qëndrimin e pretendimet e tyre respektivisht, dhe që nuk janë paraqitur deri në këtë moment të procedurës hetimore, pranë KMD-së.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 22.05.2025, pranë Zyrës së Komisionerit, në prani të palëve në proces. Pala ankuese u përfaqësua në këtë seancë nga Av. D. N.

Pala kundër së cilës është depozituar ankesa ishte e pranishme personalisht në seancë, si dhe e asistuar nga Av. I. G.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Secila nga palët shprehu qëndrimin dhe argumentat e saj respektive lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, të cilat në thelb janë të njëjta dhe në përuthje me ato të paraqitura shkresërisht pranë

KMD-së. (Pasqyruar këto në procesverbalin e mbajtur gjatë seancës, si dhe regjistrimin audio të saj⁹).

Përfaqësuesi i “Qendrës Multifunksionale Nërkulturore Shkodër” (referuar në vijim edhe si Kopshti ose Kopshti Ndërkulturor), gjatë seancës depozitoi në cilësi prove, një deklaratë noteriale, datë 05.03.2025¹⁰, të nënshkruar nga 6 (gjashtë) prindër¹¹, fëmijët e të cilëve frekuentojnë Kopshtin në fjalë, përmbajtja e së cilës do të analizohet më poshtë në arsyetimin e Komisionerit.

4. Nëpërmjet e-mailit datë 09.06.2025, përfaqësuesja e palës ankuese ka informuar Komisionerin, se:

“Këto ditë jemi njoftuar se drejtimi i Kopshtit i ka kaluar një personi tjetër. Mendojmë se kjo gjë ka lidhje me çështjen e znj. H tek Komisioneri, dhe, nëna e fëmijës mendon se kjo gjë është bërë qëllimisht nga znj. Karoline për të shmangur përgjegjësinë e saj për rastin, duke qenë se ajo si drejtuese e Kopshti ka nisur mesazhet dhe ka pasur komunikimin me nënën e fëmijës, duke qenë drejtpërdrejtë e përfshirë në sjelljen diskriminuese ndaj E.

Në këtë pikë, kërkojmë nga KMD-ja, të na lejojë të orientojmë pretendimin tonë për diskriminim të fëmijës jo vetëm kundrejt institucionit/Kopshtit, por edhe ndaj ish-drejtueses K. K, si individ, për të eliminuar çdo mundësi për shmangie përgjegjësie.”

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të fëmijës E. H.

Në bazë të informacionit dhe akteve të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se:

Është fakt i pranuar nga të dyja palët në proces se, fëmija E. H ka filluar të frekuentojë Kopshtin Ndërkulturor Shkodër, me datë 03.07.2024.

Rreth muajit gusht/shtator 2024, sipas nënës, fëmija E, i cili ishte 3 vjeç në atë kohë, pretendoi se ishte vajzë, dhe nëna pasi konsultoi këtë fakt me një psikolog amerikan, pranoi kërkesën e E dhe informoi dhe stafin e Kopshtit¹² (lidhur me këtë situatë dhe këshillat e psikologes amerikane) duke u kërkuar që të mos e quajnë E si djalë dhe të shmangin përmrat “ai/atij”, pasi këshilla e psikologes ishte: *“thjesht të jeni të respektueshëm e mirëkuptueshëm për atë që E thotë se ndjen përbrenda dhe mos debatoni. Mos i kushtoni më shumë vëmendje sesa është e nevojshme.”*

⁹ Prova të cilat janë depozituar në cilësi prove, në dosjen e palës ankuese, pranë KMD-SË.

¹⁰ Me Nr. rep. 252, Nr. Kol. 74, datë 05.03.2025, të Noteres M. N.

¹¹ Znj. M.K, znj. A. Sh, znj. E. Ç, z. B. B, Z. Xh. Sh dhe znj. E. K.

¹² Sms i datës 5 dhjetor 2024.

Pas një periudhe mësimi rreth 8 mujore në Kopsht, në datën 05.01.2025, nëna e fëmijës (E), ka lajmëruar mësuesit, prindërit e fëmijëve të tjerë dhe drejtuesit e Kopshtit nëpërmjet komunikimit në grup në Whatsapp, se do të organizonte një festë me rastin e ditëlindjes së E, në datën 30 janar 2025, ora 17:00, në një ambient të ndryshëm nga ai i kopshtit, pas orarit mësimor dhe se të gjithë ishin të ftuar.

Në festën e ditëlindjes, nëna e E, kishte përcaktuar se tema do të ishte “Piratët dhe Zanat”, prandaj nëse dëshironin, fëmijët mund të vishnin një kostum të tillë në festë.

Fëmija E, (seksi i të cilit në dokumentat e identifikimit është “mashkull”) kishte vendosur që në festën e ditëlindjes së tij të vishte një kostum zane.

Në datën 30.01.2025, ora 14:00, nëna e fëmijës ka marrë mesazh nga drejtuesja e Kopshtit, znj. K (njëherësh dhe themeluesja e Kopshtit), me këtë përmbajtje: *“Përshëndeje, W! Sapo dëgjova që E do vishet si zanë sot. Eshhtë e vërtetë? Sapo mora një mesazh ankues nga një prind dhe të siguroj se do vijnë edhe të tjerë, nëse kjo është e vërtetë. E di se po organizon një festë private, por ftove të gjithë përmes grupit të Kopshtit, kështu që kjo situatë është përgjegjësi e imja”*.

Rezulton e pohuar dhe pranuar nga të dyja palët se, ky mesazh ka vijuar me një komunikim telefonik mes nënës së E dhe drejtueses së Kopshtit. Nëna pretendon se nga ana e znj. K i është pohuar se nëse kjo gjë do të ndodhte, E nuk mund të shkonte më në Kopshtin Ndërkulturor.

Ditëlindja u organizua pasditen e datës 30 janar 2025, ku morën pjesë disa fëmijë me prindërit e tyre dhe mësueset e Kopshtit, por jo drejtuesit e tij.

Pas datës 30 janar 2025, pas festës së ditëlindjes së E, znj. K e hoqi nënën e E, nga grupi i Whatsapp, që kishte me prindërit e tjerë të fëmijëve të Kopshtit.

Prej datës 31 janar 2025, nëna e fëmijës nuk ka dërguar më në Kopsht E, duke ndërprerë kështu dhe frekuentimin e tij.

Nëna e E pretendon se fëmija i saj është diskriminuar nga ana e drejtueses së Kopshtit, pikërisht për shkak të supozimit nga ana e tyre të identitetit të tij gjinor, për shkak të veshjes së tij si zanë në festën e tij të ditëlindjes. Kjo pasi, znj. K e ka shprehur haptazi se nëse kjo gjë do të ndodhte, fëmija nuk do të pranohej më në Kopsht, siç dhe ka ndodhur realisht më pas.

Në mbështetje të këtij pretendimi, nëna e E, ka paraqitur si provë komunikimin nëpërmjet mesazheve, një javë pas ngjarjes së ditëlindjes, me Drejtuesen e Kopshtit, znj. K, ku znj. H, i drejtohet si më poshtë citohet:

“Pas reflektimit mbi ngjarjet e javës së kaluar, po përpiqem të kuptoj se si u trajtua kjo situatë nga ju, veçanërisht duke marrë parasysh gjërat lënduese e të pasakta që thatë. Unë po ju pyes

drejtpërdrejtë: A besoni se veprimet dhe fjalët tuaja ishin të drejta ndaj meje dhe E? Dhe a mendoni vërtet se shkolla juaj është një vend më i mirë dhe më gjithëpërfshirës pas këtij incidenti?

Unë besoj se çdo fëmijë meriton të ndihet i sigurt dhe i pranuar, dhe ende shpresoj për një zgjidhje që mund të ndihmojë në rregullimin e gjërave. Kjo zgjidhje nuk do të përfshijë lejin nga ana juaj për kthimin e E në Kopsht sigurisht, por ndoshta ka një mënyrë që ne të ndahemi miqësisht dhe E të marrë kërkimin e faljes që meriton.”

Në përgjigje të këtij mesazhi, znj. K, shprehet se:

“Nuk jam e sigurt se çfarë ke në mendje. Shqetësimi im ishte për E, se ti po e ekspozon fëmijën tënd. Dhe kisha të drejtë. E nuk i bëri asnjë nder ekspozimi që i bëre ti para të gjithë prindërve. Prindërit i shprehën shumë qartë rezervat e tyre. Kjo nuk ndodhi për shkakun tonë, por sepse ti e ekspozove fëmijën dhe e vendose E edhe një herë në qendër të vëmendjes. Unë të paralajmërova për këtë. Ne e pranuan fëmijën tënd gjatë gjithë kohës edhe pse E ishte shumë i vështirë në sjelljen e tij dhe dëmtoi fëmijët e tjerë. Ishin disa situata ku ishte rrezik për shkollën tonë të mbante E. Unë kushtova shumë orë të kohës time të lirë për ta ndihmuar.”

Duke analizuar sa më sipër, sjelljen, qëndrimin, parashtrimet si dhe faktet e provat e depozituara, Komisioneri, lidhur me sjelljen e veprimet e konsumuara nga ana e Kopshtit, mban qëndrimin si më poshtë:

- Lidhur me përjashtimin e fëmijës nga Kopshti, pa pasur një akt shkresor të formalizuar

Komisioneri vëren se, në rrethanat e çështjes objekt të kësaj ankese, pavarësisht faktit se mungon një akt shkresor formal për përjashtimin e fëmijës E nga Kopshti, duke analizuar provat, deklaratimet e faktet konkrete (siç është sms e datës 30 janar 2025, i drejtueses së Kopshtit, znj. K drejtuar nënës së fëmijës E), drejtuesja e Kopshtit ia kishte bërë të qartë nënës së E, se, nëse E do të vishej me kostum zane në festën e ditëlindjes së tij, ai nuk do të ishte më i mirëpritur në Kopsht. Po kështu, sjellja e drejtueses, u konfirmua më tej me veprime konkludente edhe të nesërmen e ditëlindjes së E, me datë 31 janar 2025, kur hoqi nga grupi i prindërve të fëmijëve të Kopshtit nënës e E.

Komisioneri gjen të pajustificuar arsyen e paraqitur nga drejtuesja e Kopshtit se znj. H ishte hequr nga grupi i prindërve të fëmijëve në whatsapp, pasi ajo mund ta përdorte grupin e prindërve për të shkaktuar dëme të tjera.

Qëndrimi i Kopshtit lidhur me përjashtimin e fëmijës “*de facto*” mbështet edhe nga fakti se ata nuk paraqitën asnjë provë apo deklaram se, pas kësaj ngjarje, apo dhe pasi nëna nuk e dërgoi fëmijën në Kopsht të nesërmen e ditëlindje, të kishin shfaqur interesim për mosfrekuentimin nga E.

Duke analizuar sa më sipër, Komisioneri, konkludon se, pavarësisht mungesës së një akti formal përjashtimi nga kopshti, thëniet e kryera, fshirja e nënës nga grupi i prindërve, mosinteresimi se përse fëmija nuk po shkonte në kopësht, mosqartësimi në asnjë moment se “përjashtimi nga grupi i prindërve nuk do të thotë përjashtim i fëmijës, por “menaxhim situatë”, pranimi në shumë

momente gjatë parashtrimeve të paraqitura në vijim të ankesës se kjo situatë është kërcënuese dhe rrezikon fëmijët e tjerë etj., krijojnë plotësisht bindjen se përjashtimi faktik i E ka ndodhur.

Gjithashtu, në parashtrimet e Kopshtit Ndërkulturor nuk mohohet në asnjë moment se drejtuesja e Kopshtit nuk e ka deklaruar këtë thënie. Në këto kushte, ku E. H, efektivisht dhe faktikisht prej 31.01.2025, e nesërmja e datës ku u vesh si zanë në ditëlindjen e tij, nuk e frekuenton më Kopshtin, është e qartë se paralajmërimi për përjashtim dhe më pas përjashtimi faktik kanë ndodhur, kanë qenë të vërteta dhe të mirëmbledhura, çka e bën ekzistencën e një akti formal përjashtimi plotësisht jorelevante, në kushtet ku të gjitha pasojat faktike të përjashtimit kanë ardhur.

- ***Lidhur me argumentet e paraqituara nga ana e Kopshtit për sjelljen “agresive dhe shkatërruese” të fëmijës gjatë kohës së qëndrimit të tij aty***

Komisioneri, vëren se, argumentet e paraqituara nga ana e Kopshtit për sjelljen dhe karakterin e fëmijës E. H, (që lidhen me momentet para datës 30 janar 2025) duke e portretizuar atë si agresiv dhe shkatërrues, nuk qëndrojnë dhe nuk mund të merren në konsideratë apo të analizohen, për shkak se:

- janë paraqitur në kushtet e mungesës së relevancës në lidhje me objektin e ankesës, e cila ka si objekt diskriminimin e fëmijës E. H, për shkak të identitetit gjinor të perceptuar të tij;
- parashtrimet që lidhen me trajtimin e tij nga institucioni në të shkuarën dhe në lidhje me sjelljen e tij brenda institucionit (para datës 30 janar 2025) janë irrelevante për t'u shqyrtuar në kuadër të kësaj ankese, e cila lidhet me një moment specifik dhe konkret, që fillon me festën e tij të ditëlindjes në 30 Janar 2025 e në vazhdim;
- nga ana e Kopshtit nuk është provuar me fakte e prova se, ka pasur ndonjë njoftim formal apo paralajmërim zyrtar apo verbalisht, ndaj nënëns së fëmijës për përjashtim të tij për shkak të sjelljes. Komisioneri vëren se, nëse fëmija ka qenë agresiv, shkatërrues dhe veçanërisht i rrezikshëm për fëmijët e tjerë, apo dhe vetë institucionin, do të kishte qenë e arsyeshme që nga ana e institucionit ky fakt të provohej dhe të dokumentohej mes masave formale të marra ndaj fëmijës.
- ***Lidhur me pretendimin se prindërit e fëmijëve të Kopshtit kanë reaguar dhe shprehur pakënaqësi lidhur me sjelljen e fëmijës E dhe përpjekjeve të znj. H për të ndryshuar identitetin gjinor të fëmijës***, Komisioneri vlerëson se:

Për të mbështetur këtë pretendim, drejtuesja e Kopshtit, në seancën dëgimore paraqiti në cilësinë e provës një deklaratë noteriale me Nr. rep. 252, Nr. Kol. 74, datë 05.03.2025, të Noteres M. N., nga 6 (gjashtë) prindër të fëmijëve të Kopshtit në të cilën thuhet se:

“Ne jemi prind të fëmijëve tonë të mitur, të cilët janë pjesë e Kopshtit “Qendra Multifunksionale Ndërkulturore” Shkodër.

Me anë të këtij deklarimi, shprehim bindjen tonë se në një institucion me fëmijë nga 3-6 vjeç nuk është vendi i duhur për të diskutuar temën e “ndryshimit të identitetit të gjinisë”. Kemi shqetësimin se kjo ndikon në zhvillimin e fëmijëve tonë. Drejtori e Institucionit “Qendra Multifunksionale Ndërkulturore” duhet të sigurohet për këtë.”

Komisioneri vlerëson se, kjo deklaratë noteriale nuk përbën provë dhe as indicie për ankesën në shqyrtim për këto shkaqe:

- Në ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, në nenin 62¹³ dhe 63¹⁴, të tij, janë parashikur kompetencat dhe veprimet juridike që bëhen në zyrat noteriale. Krahës kësaj, para noterit kryhen dhe veprime noteriale që parashikohen në ligje të tjera.
- Thelbësore dhe esenciale për të kryer një veprim juridik të dyanshëm apo të njëanshëm para noterit, është interesi dhe pasoja juridike e veprimit apo aktit juridik të kryer para noterit, e të parashikuar si të tillë nga ligji.
- Sigurisht që para noterit mund të bëhen deklarime noteriale individuale apo në grup, në ato raste kur këto deklarata kanë pasojë dhe efekt juridik.
- Deklarimet para noterit bëhen për fakte që kanë vlerë juridike, dhe jo deklarime për çfarëdolloj fakti apo mendimi, opinionin, përshtypje apo hamendësimi të mundshëm.

Në këtë kuadër, deklarimi noterial i 6 (gjashtë) prindërve të Kopshtit Ndërkulturore Shkodër, referuar përmbajtjes së këtij akti, është thjesht një akt pa vlerë juridike në lidhje me çështjen, për këto arsye:

- Ky deklarim noterial është bërë me datë 05.03.2015, pas largimit të fëmijës E, nga Kopshti (me datë 31 janar 2025) dhe, nga mënyra e formulimit është “copy paste” e pretendimeve dhe arsyetimit të Kopshtit, në lidhje me ankesën në shqyrtim;
- Kjo deklaratë noteriale e paraqitur në seancë dëgjimore, është një përpjekje e Kopshtit për të justifikuar dhe legjitimuar veprimet e tij, me një “provë” të krijuar *post factum*, pra pas largimit të fëmijës E nga Kopshti.
- Ndryshe nga përmbajtja e deklaratës noteriale, e cila rezulton e diktuar dhe imponuar, nuk rezulton e nuk provohet se në Kopsht të jetë shtruar për t’u diskutuar tema e ndryshimit të identitetit gjinor, sjelljeve a veshjes së E, etj.
- Në këtë rast, perceptimi i gabuar dhe paragjykimin i drejtueses së Kopshtit në lidhje me fëmijën E, është bërë pjesë e kësaj deklarate noteriale.

Komisioneri vëren se, nëse ndonjë apo disa nga prindërit e fëmijëve të Kopshtit do të kishin ndonjë pakënaqësi, shqetësim në lidhje me funksionimin e Kopshtit apo ndikimin e papërshtatshëm, jo edukativ apo keq ndikues të ndonjë fëmije tjetër, atëherë do të duhej të ishin drejtuar me kërkesë individuale apo në grup, drejtueses së Kopshtit, duke shprehur pretendimet e shqetësimet e tyre, me qëllim dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës.

¹³ Kompetencat e noterit

¹⁴ Detyrat e noterit

Në parim, nëse thëniët e një apo disa personave kanë interes për një çështje, ankesë të caktuar, ato bëhen pranë institucionit përkatës, pranë organit administrativ apo në gjykatë e prokurori, (për çështjet gjyqësore e penale) në formën e përcaktuar në ligjet përkatëse, pasi vetëm në këtë mënyrë kanë vlerë juridike dhe përbëjnë prova për çështjet apo ankeat në shqyrtim.

Gjithsesi, referuar edhe sa më sipër, Komisioneri e konsideron deklaratën e mësipërme noteriale jo relevante për ankesën në shqyrtim.

- ***Lidhur me qëndrimin e Kopshtit përsa i takon interpretimit që i bën identitetit gjinor të fëmijës E.***

Në parashtrimet e dërguara nga ana e Kopshtit, evidentohet qartë dhe qëndrimi i tij lidhur me faktin se si e kanë perceptuar dhe interpretuar “identitetin gjinor” të fëmijës E, pikërisht për shkak të supozimit nga ana e tyre të identitetit të tij gjinor, për shkak të veshjes së tij si vajzë, apo për faktin se dëshironte t’i drejtoheshin me “ajo” dhe jo “ai”.

Ky fakt dëshmohet nga citimet e shkëputura nga parashtrimet e Kopshtit, si:

- *“....mbajtje e komunikimit intensiv me nënën para, gjatë dhe pas ndryshimit të seksit të fëmijës;*
- *një institucion për fëmijë 3 (tre) - 6 (gjashtë) vjeç nuk është vendi i duhur për një diskutim mbi ndryshimin e identitetit të seksit;*
- *në institucion po ndodhte një seksualizim i parakohshëm i fëmijëve;*
- *nuk bëhej fjalë vetëm për faktin që E ishte veshur si zanë, por për një tranzicion të plotë gjinor të një fëmije të vogël;*
- *kjo temë është tabu për shoqërinë shqiptare;*
- *E konfuzion fëmijët e tjerë, etj”*

Komisioneri konkludon se, nisur nga këto thënie, (pjesë e parashtrimeve dhe qëndrimit të Kopshtit Ndërkulturor) shihet qartë një moskuptim faktik dhe një paragjykim mbi situatën konkrete të E dhe portretizimi i nënës së fëmijës si një person që po “nxit forcërisht” identitetin gjinor të fëmijës, gjë që është absolutisht e pavërtetë, pasi vetë Kopshti Ndërkulturor në vijim të parashtrimeve të paraqitura para KMD-së, mes mesazheve të nënës së fëmijës znj. H, që i ka paraqitur si prova, ka cituar se ajo është shprehur qartë se pasi u konsultua me ekspertin psikolog nga SHBA në lidhje me situatën e E, kërkoi nga personeli i Kopshtit “...të jenë të respektueshëm për atë që E thotë se ndjen, të mos debatojnë duke e vendosur në dyshim identitetin e fëmijës dhe nga ana tjetër të mos i kushtojnë më tepër vëmendje se ç’është e nevojshme kësaj teme”.

Kjo prove, përballë argumentit se nëna e E kishte qëllime shkatërruese ndaj institucionit dhe fëmijëve të tjerë dhe kërkonte me ngulm nga kopshti t’i referohej fëmijës si vajzë, përpiquej me ngulm të ndryshonte identitetin seksual të fëmijës së saj dhe nuk edukon drejt fëmijën, është tregues i qartë i parashtrimeve kontradiktore dhe paragjykit të përfaqësuesve të Kopshtit Ndërkulturor ndaj situatës së E. H, çka më pas ka sjellë përjashtimin nga institucioni në mënyrë efektive,

pavarësisht ekzistencës ose jo të një njoftimi formal, për sa kohë me veprime dhe mosveprime kanë bërë që përjashtimi të dukej sikur kishte ndodhur.

Në lidhje me sa është paraqitur më sipër mbi situatën e fëmijës E. H dhe nisur nga qëndrimi e sjellja e Kopshtit karshi fëmijës, Komisioneri konkludon se:

Fillimisht është e rëndësishme të theksohet se, fëmija E. H nuk ka kryer asnjë lloj procedure që lidhet me ndërrimin e seksit, siç prezantohet nga parashtrimet e Kopshtit ndërkulturore. Fëmija është dukshëm, siç është konfirmuar edhe nga eksperti psikolog, në një fazë zhvillimi të personalitetit të tij, ndër të tjera, si pjesë e tij, edhe të eksplorimit të shprehjes së gjinisë dhe identitetit të vet gjinor, një fazë kjo mjaft e zakonshme në zhvillimin e hershëm të çdo fëmije. Respektimi dhe mbështetja e një fëmije që kalon në këtë fazë të eksplorimit të vetes, është në fakt respekt për lirinë e shprehjes dhe interesin më të lartë të fëmijës - gjykime këto referuar specialistëve të fushës¹⁵.

Komisioneri evidenton faktin se, drejtuesja dhe stafi i Kopshtit kanë qenë plotësisht të informuar nga nëna e fëmijës se, nuk kishte ndodhur asnjë ndryshim seksi tek E, çka i bën deklaratimet e tyre në parashtrime të pavërteta.

Narrativa e krijuar nga përfaqësuesit e Kopshtit, duke u përpjekur ta paraqesin këtë fazë normale të eksplorimit të identitetit dhe shprehjes gjinore të fëmijës si një ngjarje të jashtëzakonshme, tabu në realitetin shqiptar, që dëmton dhe konfuzion fëmijët e tjerë, shkatërron institucionin dhe vendos një barrë të padrejtë mbi të, krijon dhe përforcon në vetvete një paragjykim dhe stereotip ndaj fëmijës E.

Për më tepër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Kopshtit nuk është depozituar asnjë provë bindëse lidhur me faktin se si kishte ndikuar sjellja e E tek fëmijët e tjerë, si kishte përkeqësuar apo afektuar sjelljen, zhvillimin apo mirëqenien e tyre emocionale.

Po ashtu, Komisioneri vëren se, nuk janë depozituar fakte e prova që provojnë se prindërit e fëmijëve të tjerë kanë paraqitur ndonjë pakënaqësi apo të jenë ankuar për sjelljet e E apo mënyrën e tij të veshjes, qëndrimit etj, gjatë kohës që E frekuentonte Kopshtin.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri thekson se, nga ana e Kopshtit është depozituar një deklaratë e nënshkruar nga 6 prindër të Kopshtit¹⁶ (nga 25 fëmijë që ka ai, sipas deklaramve të Kopshtit) e cila daton disa muaj pasi E ishte larguar nga Kopshti. Komisioneri vlerëson se, këto deklarime nuk janë koherente dhe as të besueshme, nisur qoftë nga koha kur janë depozituar, qoftë edhe nga

¹⁵ Gu et al., 2017 Prospective longitudinal; ALSPAC cohort – Childhood gender – typed behavior (Pre-School Activities Inventory, PSAI...)

¹⁶ *Ne jemi prind të fëmijëve tonë të mitur, të cilët janë pjesë e Kopshtit "Qendra Multifunkionale Ndërkulturore" Shkodër. Me anë të këtij deklarimi, shprehim bindjen tonë se në një institucion me fëmijë nga 3-6 vjeç nuk është vendi i duhur për të diskutuar temën e "ndryshimit të identitetit të gjinisë". Kemi shqetësimin se kjo ndikon në zhvillimin e fëmijëve tonë. Drejtori e Institucionit "Qendra Multifunkionale Ndërkulturore" duhet të sigurohet për këtë.*

përmbajtja e tyre, e cila vjen në përputhje të plotë me qëndrimin e mbajtur nga Kopshti para KMD-së.

Në tërësi e argumenteve të sjella në parashtrimet e Kopshtit Ndërkulturor, vihet re qasja e justifikimit të ngjarjes për shkak të përpjekjes së *“balancimit mes të drejtave të një fëmije specifik dhe interesit të përgjithshëm të fëmijëve, prindërve të tjerë dhe institucionit”*.

Komisioneri vëren se, ky argument nuk qëndron, pasi është i pabazuar në ligj dhe i pajustificuar objektivisht. Në argumentat e sjella nga Kopshti Ndërkulturor është pranuar se ata kanë bërë një vlerësim *“mes të drejtave të E dhe të drejtave të fëmijëve e prindërve të tjerë”*. Ky parashtrim tregon edhe njëherë se E nuk është parë si i barabartë me fëmijët e tjerë dhe interesi më i lartë i tij nuk ka qenë prioritar.

Ky argument përdoret nga Kopshti Ndërkulturor si justifikim mbi trajtimin e E, duke dëshmuar kështu se trajtimi më pak favorizues ndaj E ka ndodhur, për sa kohë Kopshti Ndërkulturor sjell argumente për ta justifikuar këtë trajtim, ndër të cilat *“në një institucion me 25 fëmijë është ekonomisht shkatërruese që për këtë shkak të largohen 5 fëmijë”*.

Nga ana tjetër, ky argument e bën të qartë se arsyeja e vërtetë e këtij vendimi për përjashtimin faktik të fëmijës nga institucioni arsimor, është nxitur nga frika ose hamendësimi i Kopshtit se prindërit mund të hiqnin fëmijët e tyre, dhe se qëllimi ishte të shmangnin pasojat financiare e ekonomike të Kopshtit. Në asnjë moment nuk argumentohet nga Kopshti Ndërkulturor as se si dhe për cilat arsye respektimi i identitetit dhe zhvillimit të personalitetit të E, (ku shprehja gjinore është pjesë e pandarë e tij) dëmton fëmijët e tjerë dhe prindërit e tyre, dhe as që prindërit të kishin paraqitur ankesa lidhur me këtë fakt, gjatë kohës që E frekuentonte Kopshtin, me qëllim që të ishin marrë masat përkatëse sipas pretendimit të tyre.

Në parashtrimet e Kopshtit Ndërkulturor thuhet se, bazuar edhe në shqetësimin e prindërve, kjo temë përbën *“seksualizim të parakohshëm të fëmijëve”*.

Komisioneri konkludon se, ky argument i përdorur nga drejtuesit e një institucioni edukimi është i pabazuar, pasi:

së pari, është shkencërisht jo i saktë;

së dyti është paragjykes dhe përforcon stereotipe të dëmshme;

së treti, në asnjë moment E dhe nëna e tij nuk kanë kërkuar apo pritur që Kopshti ndërkulturor të organizonte diskutime të hapura mbi seksualitetin apo ndryshimin e gjinisë, por vetëm që faza e eksplorimit të E me shprehjen e personalitetit (pjesë e të cilit konsiderohet dhe shprehja e gjinisë së tij) të respektohej, përkundrazi, pa e bërë atë një temë shumë të rëndësishme, kjo edhe sipas sugjerimeve të psikologut ekspert.

Për më tepër, Komisioneri gjykon se, nëse fëmijët e Kopshtit do të ishin edukuar me frymën e pranimi të diversitetit dhe respektit të njëri tjetrit, pavarësisht pamjes së jashtme dhe konformitetit me rolet gjinore, veshja e një fustani nga ana e E nuk do të ishte një temë për diskutim.

Qasja e parashtruar në argumentet e Kopshtit Ndërkulturor është qartazi e pabazuar dhe reflekton një mungesë të thellë kuptimi mbi identitetin gjinor, shprehjen gjinore, lirinë e shprehjes së çdo fëmije dhe të drejtat e fëmijës në tërësi.

Komisioneri, thekson se, thënie se një fëmijë *“nuk është më i mirëpritur në kopsht nëse vishet si zanë”*, diskutimet se kjo temë është tabu, shqetësimet se fëmijët e tjerë dëmtohen dhe konfuzohen, përveçse në rastin konkret janë të pabaza, të paprovuara e faktuara, janë dhe të papranueshme për t'u artikuluar nga një institucion arsimor, i cili do të duhet të promovonte barazinë dhe respektin për çdo fëmijë, pavarësisht karakteristikave të tij dhe dëshmojnë qartë paragjykimin e brendësuar gjë që është reflektuar në përjashtimin faktik të fëmijës nga Kopshti.

Duke analizuar në tërësi, gjithë sa më sipër, Komisioneri, konkludon se, pavarësisht mungesës së një akti formal përjashtimi nga Kopshti, sjellja dhe veprimet konkludente të kryera prej tij (*thënie e kryera, fshirja e nënës nga grupi i prindërve, mosinteresi se përse fëmija nuk po shkonte në kopsht, mosqartësimi në asnjë moment se “përjashtimi nga grupi i prindërve nuk do të thotë përjashtim i fëmijës, por “menaxhim situatë”*), pranimi në shumë momente gjatë parashtrimeve të paraqitura në vijim të ankesës se kjo situatë është kërcënuese dhe rrezikon fëmijët e tjerë etj), krijojnë plotësisht bindjen se përjashtimi faktik i E ka ndodhur pikërisht pas festës së ditëlindjes së tij dhe nxitur prej faktit që ai është veshur me kostum zane, në kundërshtim me sa i ishte kërkuar nënës së fëmijës, nga drejtuesja e Kopshtit.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, deklaratimet e veprimet e Kopshtit lidhur me trajtimin e çështjes së E dhe argumentimin se *“nuk e kanë përjashtuar E nga Kopshti, por nëna e tij ka vendosur të mos e dërgojë më”*, nuk qëndrojnë, janë të paarsyetuara, të pajustificuara objektivisht, jokohërente dhe bien në kundërshtim me faktet, provat e analizuara.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se fëmija E. H i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e drejtueses së Qendrës Multifunkionale Ndërkulturore Shkodër, (*sjellja dhe veprimet e së cilës janë konkrete dhe të drejtpërdrejta, nisur nga tagri i saj si drejtuese e Kopshtit*) lidhur me përjashtimin *de facto* të tij, për shkak të veshjes së tij me kostum zane dhe manifestimin e dëshirës dhe kërkesës për t'iu drejtuar me përemrat e gjinisë femërore “ajo/asaj”, etj.

B. Shkaku i mbrojtur - Identiteti gjinor (i perceptuar)

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2, 3)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk

mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose *çdo status tjetër*.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shkaku të pretenduar nga subjekti ankues, atë të *identitetit gjinor (të perceptuar) të fëmijës E. H.*

Në nenin 1, të LMD sanksionohet se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. ”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pala ankuese pretendon se fëmija i saj është diskriminuar për shkak të *identitetit gjinor të perceptuar*. Komisioneri konstaton se shkaku i pretenduar nga ankuesja nuk parashikohet shprehimisht si shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD.

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimit, rezulton se, përjashtimi “de facto”, i fëmijë së ankueses nga Kopshti, ka ardhur për shkak të veshjes së tij me kostumin e një zane (personazhi të parapëlqyer prej tij) gjatë festës së ditëlindjes së tij dhe identitetit gjinor të perceptuar të tij, nga ana e Kopshtit.

Në parashtrimet e saj, ankuesja pretendon se, është vënë nën presion nga drejtuesja e Kopshtit që fëmija i saj të mos vishej me kostum zane, në festën që do organizonte për ditëlindjen e tij, pasi sipas saj, kjo gjë do ta ekspozonte atë para fëmijëve dhe prindërve të tjerë, duke hamendësuar kështu lidhur me identitetin gjinor të fëmijës.

Rezulton plotësisht e provuar se, pikërisht pas organizimit të festës së ditëlindjes së E, me datë 30 janar 2025, dhe komunikimit të bërë me nënën e fëmijës, (pasi rezultoi që fëmija E ishte veshur me kostum zane në festën e organizuar me rastin e ditëlindjes së tij), znj. H i është bërë e ditur qartësisht se fëmija nuk ishte i mirëpritur më në Kopsht nëse ai do të vishej me kostum zane në festën e tij të ditëlindjes, ku kishte ftuar dhe fëmijët e tjerë, prindërit e tyre dhe mësuesit e stafin drejtues të Kopshtit. Në këtë mënyrë duke ia bërë “fakt të kryer” me veprime konkrete konkludente se, pas këtij momenti ai de facto ishte i përjashtuar nga frekuentimi i Kopshtit në ditët pasuese në vijim.

Komisioneri vëren se, në rastin në fjalë, nuk kemi të bëjmë me “identitet gjinor” në kuptim të posedimit të tij nga ana e fëmijës E.

Në çështjen në shqyrtim faktet dhe rrethanat të cilat rezultojnë të provuara si dhe në bazë të pretendimeve të palëve të parashtruara para Komisionerit, rezulton se, është “identiteti gjinor i supozuar” i fëmijës dhe veshja e tij me kostum zane në festën e tij të ditëlindjes të organizuar në praninë e shokëve e shoqeve të Kopshtit, prindërve të tyre dhe mësuesve të pranishëm në të, të cilat kanë shërbyer si “shkaku i vërtetë” për përjashtimin *de facto* të tij nga Kopshti nga ana e drejtueses së Kopshtit, znj. K.

*Identiteti gjinor*¹⁷ lidhet me përvojën individuale e të brendshme të ndjerë të një personi në lidhje me gjininë, e cila mund të korrespondojë ose jo me gjininë e caktuar me lindjen e tij, duke përfshirë ndjenjën personale të trupit (*që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes ose funksionit trupor me anë të mjeteve mjekësore, kirurgjike ose mjeteve të tjera*) dhe shprehje të tjera të gjinisë, duke përfshirë veshjen, të folurën dhe sjelljen.

LMD, nuk ka një parashikim se literal të “identitetit gjinor të supozuar”.

¹⁷ Webi zyrtar i KMD-së - <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Perceptimi gjinor nga të tjerët shpesh bazohet në sjellje, pamje apo preferenca, jo domosdoshmërisht në identitetin e vërtetë të fëmijës. Fëmijët që nuk përputhen me normat tradicionale gjinore shpesh etiketohen, marginalizohen mbi bazën e këtij perceptimi paragjykses.

Mungesa *literalisht* e sa më sipër, si shkak i mbrojtur nga diskriminimi, apo trajtimi i një rasti të ngjashëm, me rastin objekt shqyrtimi, (konsideruar dhe moshë e fëmijës) konstatohet edhe për sa i përket praktikës së KMD-së, dhe asaj gjyqësore.

Për të vlerësuar nëse “identiteti gjinor të supozuar”, (duke konsideruar moshën 3-4 vjeçare, të fëmijës) përfshihet në ombrellën e shkakut të mbrojtur, sipas përcaktimeve të LMD, Komisioneri do të referohet praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe përcaktimeve të Rekomandimit nr. 17 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për parandalimin dhe luftën kundër intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI”, (miratuar më 28 qershor 2023, Strasburg)¹⁸.

Rekomandimi nr. 17 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për parandalimin dhe luftën kundër intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI”, (miratuar më 28 qershor 2023, Strasburg)¹⁹, ndër të tjera, në pikën 29, të tij, shprehet se:

“Studentët LGBTI²⁰ ndikohen ndjeshëm nga shkalla ku çështjet e orientimit seksual, identiteti gjinor dhe karakteristikave seksuale, ose çështjet që kanë të bëjnë me diversitetin në format e familjes, nuk janë të integruara në politika dhe praktika që rregullojnë të gjitha nivelet e arsimit.

Një qasje e ndjeshme, e përshtatshme për moshën dhe e hapur ndaj gjinisë dhe seksualitetit mund të nxisë respektin për studentët LGBTI dhe të parandalojë kulturat e bullizimit, ngacmimit, diskriminimit dhe dhunës.

Në të kundërt, politikat arsimore të bazuara në heshtje ose stigmatizim mund të përforcojnë marginalizimin e studentëve LGBTI dhe ato legjitimojnë paragjykimet anti-LGBTI²¹. Këto mjedise krijojnë stres akut dhe kronik dhe kanë efekt negativ në shëndetin dhe mirëqenien fizike dhe mendore të studentëve LGBTI.

Në kontekst të sa më sipër, ECRI përdor termin "studentë LGBTI" për të përfshirë të gjithë studentët LGBTI, duke përfshirë ata që janë në arsimin parashkollor dhe në kopsht.

¹⁸Shih: www.coe.int dhe www.euroa.eu

¹⁹Shih: www.coe.int dhe www.euroa.eu

²⁰ Ndërkohë që, për qëllimet e GPR Nr. 17, pranon se ekzistojnë dallime thelbësore mes studentëve në kontekste të ndryshme dhe se këto kontekste do të formësojnë mënyrën se si studentët përjetojnë diskriminimin dhe intolerancën ndaj LGBTI-ve, ECRI përdor termin "studentë LGBTI" për të përfshirë të gjithë studentët LGBTI, **duke përfshirë ata që janë në arsimin parashkollor dhe në kopsht**, si dhe, sipas rastit, nxënësit me prindër LGBTI

²¹ I sigurt në shkollë: Përgjigjet e fushës së arsimit ndaj dhunës bazuar në orientimin seksual, identitetin/shprehjen gjinore ose karakteristikat seksuale në Evropë (Këshilli i Evropës, 2018), 37-39. Shihni gjithashtu: Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Koment për të Drejtat e Njeriut, "Edukimi gjithëpërfshirës i seksualitetit mbron fëmijët dhe ndihmon në krijimin e një shoqërie më të sigurt, përfshirëse" (21 korrik 2020)

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi si dhe standardet dhe rregullimet ligjore në fuqi, Komisioneri vlerëson se, në asnjë moment apo rast, nga prindi i fëmijës nuk është deklaruar apo pohuar tek stafi i Kopshtit se, fëmija E. H ka kryer ndonjë lloj procedure që lidhet me ndërrimin e seksit, siç prezantohet nga parashtrimet e Kopshtit ndërkulturor.

Fëmija është dukshëm, siç është konfirmuar edhe nga eksperti psikolog, në një fazë eksplorimi të shprehjes së gjinisë dhe identitetit të vet gjinor, një fazë kjo mjaft e zakonshme në zhvillimin e hershëm të çdo fëmije. Respektimi dhe mbështetja e një fëmije që kalon në këtë fazë të eksplorimit të vetes, është në fakt respekt për lirinë e shprehjes dhe interesin më të lartë të fëmijës - gjykime këto referuar specialistëve të fushës²².

Lidhur me sa më sipër, (Shprehjen e demonstrimit të sjelljeve të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, lidhur me preferencat që kanë të bëjnë me gjininë), Komisioneri, ka hulumtuar studime dhe artikuj të ndryshëm shkencorë²³ nga ekspertë të fushës, të cilët ndër të tjera, shprehen se:

Referuar Rae et al (2019) – “Predicting early childhood gender transitions²⁴”, bëhet një dallim i qartë midis:

- Eksplorimit të roleve gjinore (veshje, lodra, sjellje) në fëmijëri, që është shpesh i përkohshëm dhe i zakonshëm;
- Dhe, identitetit të qëndrueshëm gjinor (në rastet kur fëmija shfaq konsistencë, insistim dhe këmbëngulje në përkatësinë gjinore jo sipas gjinisë biologjike)
- Pra, eksplorimi gjinor në moshë të vogël është i zakonshëm dhe nuk është tregues i domosdoshëm i një tranzicioni apo Orientimi të mëvonshëm seksual apo gjinor.

²² Gu et al., 2017 Prospective longitudinal; ALSPAC cohort – Childhood gender – typed behavior (Pre-School Activities Inventory, PSAI...)

²³ Steensma et al., 2013 Prospective longitudinal - Childhood gender – typed behavior (Pre-School Activities Inventory, PSAI...);

Green et al, 1987, - Childhood cross-gender behavior; Gender-typed or cross-gender behavior was measured in early childhood (as young as 2.5 years in Gu

et al., 2017) or retrospectively reported for childhood (Green et al., 1987).

Gu Li, Karson T. F. Kung, and M. Hines. “Childhood Gender-Typed Behavior and Adolescent Sexual Orientation: A Longitudinal Population-Based Study.” *Developmental Psychology*, 2017.

- Richard Green, Carl E. Roberts, Katherine Williams, M. Goodman, and A. Mixon. “Specific Cross-Gender - - Behaviour in Boyhood and Later Homosexual Orientation.” *British Journal of Psychiatry*, 1987.

T. Steensma, J. Ende, F. Verhulst, and P. Cohen-Kettenis. “ORIGINAL RESEARCH—INTERSEX AND GENDER IDENTITY DISORDERS Gender Variance in Childhood and Sexual Orientation in Adulthood: A Prospective Study,” 2013

<http://revistapsikologji.com/zerina-qendro-identiteti-gjinor-ne-femijeri/>

²⁴ Parashikimi i tranzicionit gjinor në fëmijërinë e hershme (përkthim i Komisionerit).

Egan & Perry (2001) “Gender identity: a multidimensional analysis...”, është një studim, i cili prezanton një model të ndërlikuar të zhvillimit të identitetit gjinor, ku ndjesitë ndaj vetes, presioni shoqëror dhe krahasimi me gjininë tjetër ndërveprojnë.

Fëmijët që eksperimentojnë me role gjinore nuk kanë domosdoshmërisht një krizë identiteti, por, janë duke formuar kuptimin e tyre për veten në një proces normal zhvillimi.

Shkencërisht nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes preferencave të hershme (lodra, veshje, etj) dhe orientimit seksual.

Sipas Martin (2009) “Normalising heterosexuality...”, shmangia nga normat gjinore (psh një djalë që luan me kukulla në moshën 3 vjeç) nuk parashikon që ai do të jetë homoseksual, dhe, është më e dëmshme kur prindërit i japin shumë peshë këtij fakti. Lejimi nga ana e prindërve i eksplorimit të fëmijëve, pa gjykim, pa nxitur frikë apo kufizim, është thelbësore dhe ndihmon në mirëqenien emocionale të tyre. Nga ekspertët e fushës sugjerohet që, eksplorimi gjinor në këto mosha nuk ka nevojë të kontrollohet, por të pranohet si pjesë e zhvillimit.

Shumer et al (2016) “Avaluation of Asperger Syndrome in youth...”, nënvizon rëndësinë e mosdaljes në konkluzione dhe përfundime të shpejta për fëmijët me sjellje të pazakonta gjinore ose sociale, pasi janë shumë faktorë që ndërveprojnë bashkarisht dhe kjo duhet parë si pjesë e normalitetit që shoqëron rritjen e tyre. Shprehja e një fëmije për preferencat që kanë të bëjnë me gjininë (me miq, aktivitete, zgjedhje veshjesh, modele flokësh, etj), nuk parashikon domosdoshmërisht se cili do të jetë identiteti i tij gjinor ose orientimi seksual i tij më vonë në jetë

Shprehja gjinore, identiteti gjinor dhe orientimi seksual nuk janë të njëjta. Identiteti gjinor - është se si ndihen brenda dhe si shprehni gjininë tuaj nëpërmjet veshjes, sjelljes dhe pamjes personale. Është një ndjenjë që fillon shumë herët në jetë. Përcaktimi i vetes në një gjini fillon që në moshën e hershme 2 ose 3 vjeç. Stereotipat e shumta na bëjnë konfuz dhe ngatërrojnë orientimin seksual me identitetin gjinor.

Shprehja e një fëmije për preferencat që kanë të bëjnë me gjininë (me miq, aktivitete, zgjedhje veshjesh, modele flokësh, etj), nuk parashikon domosdoshmërisht se cili do të jetë identiteti i tij gjinor ose orientimi seksual i tij më vonë në jetë (Shoqata Psikologjike Amerikane, 2015).

Mosha në të cilën vendoset identiteti gjinor ndryshon. Identiteti gjinor për disa fëmijë mund të jetë mjaft i fortë kur ata janë dy ose tre vjeç. Për të tjerët mund të jetë i paqartë deri në adoleshencë. Pranimi familjar i identitetit gjinor të një fëmije është një faktor kritik në zhvillimin e fëmijës (AAP, 2015; Gender Spectrum, 2012; Ryan et al, 2010). Sido që të jetë identiteti gjinor i një fëmije, një mesazh shumë i rëndësishëm që të rriturit në mënyrë të kujdesshme mund t’u japin fëmijëve të vegjël është se: *Ata janë qenie njerëzore të shëndetshme dhe të mirë.*

Të jesh djalë apo vajzë për shumicën e fëmijëve është diçka lehtësisht e dallueshme. Në lindje, foshnjat caktohen mashkull ose femër bazuar në karakteristikat fizike. Kjo i referohet “seksit” ose “gjinisë” të fëmijës. Ndërkohë, “identiteti gjinor” i referohet një sensi të brendshëm që kanë njerëzit se kush janë ata, që vjen nga një ndërveprim i faktorëve biologjikë, ndikimeve të zhvillimit dhe kushteve mjedisore. Kështu mund të jetë mashkull, femër, diku në mes, një kombinim i të dyjave.

Vetë-njohja e identitetit gjinor zhvillohet me kalimin e kohës, në të njëjtën mënyrë si trupi i një fëmije. Te shumica e fëmijëve identiteti i pohuar i gjinisë përputhet me gjininë (seksin) e caktuar. Sidoqoftë, për disa fëmijë, ndeshja midis gjinisë së tyre dhe identitetit gjinor nuk është aq e qartë.

Të dhënat nga një numër studimesh kanë konfirmuar këtë progresion teorik:

Rreth moshës trevjeçare pothuajse shumica e fëmijëve shpalosin një identitet gjinor më të madh. Stabiliteti gjinor vijon në moshën katërvjeçare dhe konsistenca gjinore rreth pesë vjeç. Meshkujt dhe femrat përparojnë përmes këtyre stadeve pak a shumë në të njëjtën kohë. Ky përparim është demonstruar në një seri kulturash, megjithëse fëmijët në shumë vende jo-perëndimore shfaqet se përparojnë përmes këtyre stadeve në një mënyrë më të ngadaltë, (Unger, 2004).

Të gjithë fëmijët kanë nevojë për mundësinë për të eksploruar role të ndryshme gjinore dhe stile të ndryshme loje. Prindërit mund të sigurohen që mjedisi i fëmijës së tyre të vogël pasqyron diversitetin në rolet gjinore dhe inkurajon mundësitë për të gjithë.

Duke konsideruar sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, fëmija E. H, ka demonstruar sjellje të qarta të eksplorimit të identitetit gjinor, (me veshjet, lodrat, etj) sipas shpjegimeve të mësipërme të ekspertëve të fushës, brenda normalitetit moshor të tij (si një fëmijë 3 vjeçar) dhe se këto sjellje të tij (veshja, lodrat, etj) janë perceptuar në mënyrë të gabuar nga ana e Kopshtit si *manifestim i identitetit të tij gjinor, apo ndryshimit të gjinisë në lindje, tranzicionit të tij gjinor*, duke pasqyruar dhe përjashtimin e tij nga Kopshti, nxitur nga frika se kjo gjë *mund* apo *ka* ndikuar tek *konfuzimi i fëmijëve të tjerë*, apo i ka *dëmtuar psikologjikisht* apo në ndonjë mënyrë e formë tjetër, dhe se prindërit mund të hiqnin fëmijët nga Kopshti, duke e dëmtuar atë financiarisht.

Pra, edhe pse fëmija nuk posedon shkakun e “identitetit gjinor”, sipas përcaktimit të LMD-së, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, “identiteti gjinor i perceptuar” i fëmijës E. H, si i tillë nga ana e Kopshtit²⁵ (pasi pasojat (përjashtimi) fëmijës i kanë ardhur pikërisht mbi bazën e këtij perceptimi të gabuar, marrë si të mirëqenë nga ana e Kopshtit), do të pranohet si shkak i mbrojtur nën ombrellën e garancisë ligjore sa më sipër analizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një

²⁵ Drejtueses së tij, në tagrin e autoritetit përfaqësues.

kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar që adreson çështjet e pronësisë bazuar në standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”.*

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.”*

Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 16/1, i Kushtetutës së Shqipërisë, sanksionon se, *të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.*

Neni 54/1, i Kushtetutës, sanksionon se, *fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor²⁶.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

- “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...*
- 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...*

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend

²⁶ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në nenin 14 të saj, ndalon çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtave të garantuara nga Konventa, përfshirë të drejtën për jetë private dhe familjare (neni 8) dhe të drejtën për arsim, në bazë të nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të saj, çka do të thotë se çdo fëmijë ka të drejtë të mos përjashtohet nga institucionet arsimore mbi bazën e identitetit ose shprehjes gjinore, qoftë kjo faktike apo e perceptuar.

Identiteti gjinor i fëmijës, qoftë ai i konfirmuar apo i perceptuar nga të tjerët, gëzon mbrojtje nga KEDNJ.

Shtetet kanë detyrimin pozitiv të mbrojnë fëmijët nga ngacmimi dhe diskriminimi në ambientet publike, përfshirë shkollat.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës²⁷ është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës.

Disa nga të drejtat kryesore të fëmijëve, sipas Konventës, janë:

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim: të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta. Asnjë prej tyre nuk mund të diskriminohet për shkak gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale, si dhe për çdo shkak tjetër.

Interesi më i lartë i fëmijës: Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën e të Drejtave të Fëmijës duhet t'u sigurojnë mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e nevojshme të gjithë fëmijëve. Ato angazhohen ta realizojnë këtë duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, kujdestarëve të tyre ligjorë dhe personave të tjerë ligjërisht përgjegjës duke marrë masat e nevojshme legislative dhe administrative.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Në nenin 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës²⁸, parashikohet se:

1. *Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta...*

²⁷ Kjo konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

²⁸ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991.

Neni 29/1, i Konventës, sanksionon se: *“Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:*

(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;

(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.”

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), në nenin 26 të saj, afirmon të drejtën për edukim për të gjithë, ndërsa neni 2 garanton këtë të drejtë pa kurrfarë diskriminimi.

Neni 7, i saj, siguron që të gjithë individët janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë kundër diskriminimit. Në rastin e fëmijëve LGBTI, praktikat diskriminuese, që i përjashtojnë ata nga institucionet arsimore shkelin të drejtën e tyre themelore për barazi para ligjit.

Këto standarde theksohen gjerësisht edhe nga një sërë instrumentash të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përmendur, por pa u kufizuar në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (nenet 2(1), 26, 17); Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (nenet 2, 13) etj.

Për më tepër, Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor, kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë qasje të barabartë në arsim për fëmijët LGBTI dhe ata të perceptuar si LGBTI, duke përfshirë masat për të parandaluar bullizmin dhe diskriminimin në institucionet arsimore. Ky rekomandim thekson detyrimin e shteteve anëtare, ndër të cilat Shqipëria, për të garantuar që institucionet edukuese të jenë ambiente të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, duke ndaluar çdo formë përjashtimi ose trajtimi të pabarabartë për shkak të identitetit gjinor të fëmijës.

Përjashtimi nga arsimi për shkak të identitetit ose shprehjes gjinore, jo vetëm që përbën një shkelje të shumëfishtë të të drejtave të njeriut dhe specifikisht të fëmijës, por gjithashtu krijon një precedent të rrezikshëm që rrit vulnerabilitetin e fëmijëve ndaj marginalizimit, ngacmimit dhe disavantazhimit social.

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Këshilli i Evropës dhe UNICEF kanë theksuar se mjediset e institucioneve edukuese, duke përfshirë ato të edukimit të hershëm, çka referon në këtë rast kopshtet, duhet të jenë mjedise gjithëpërfshirëse, që respektojnë diversitetin e të gjithë fëmijëve dhe i mbrojnë ata nga diskriminimi, përfshirë diskriminimin mbi bazën e identitetit gjinor.

E drejta e një fëmije për të shprehur lirshëm identitetin e vet, nuk përbën një të drejtë e negociueshme që mund të peshohet e vendoset përballë të drejtave të fëmijëve dhe prindërve të tjerë apo institucionit në tërësi. Çdo fëmijë është i barabartë përpara ligjit, pavarësisht çdo karakteristike të mbrojtur. Mbartja e një apo më shumë karakteristikave të mbrojtura nga një fëmijë nuk e bën interesin më të lartë të këtij fëmije më pak të vlefshëm apo të rëndësishëm sesa interesin më të lartë të fëmijëve të tjerë apo prindërve të tyre.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohen parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ligji përcakton se: “...2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.”

Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Kështu, në ligjin nr. 69/2012, të ndryshuar, në nenin 5/1²⁹ dhe 6/4/5³⁰, të tij, parashikohet respektivisht, se:

“5.1 Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

...

6.4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.

6.5. Çdo nxënës i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.”

Në nenin 2, të këtij Ligji, përcaktohet, ndër të tjera, se:

“1. “Arsimi parauniversitar” përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:

a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor.....

.....

5. “Institucion arsimor” është kopshti ose shkolla.

....

11. “Kopsht” është institucioni arsimor që ofron shërbim arsimor të nivelit me kodin 0.”

²⁹ Neni 5. E drejta për arsimim.

³⁰ Neni 6. Parime të përgjithshme.

Neni 4³¹, i Ligjit, sanksionon se: *“Sistemi arsimor parauniversitar mbështetet në traditën e arsimit shqiptar, funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe zhvillohet sipas vlerave të përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore.”*

Neni 14³², i Ligjit, përcakton se: *“Në sistemin arsimor parauniversitar funksionojnë kopshtet, shkollat dhe institucionet plotësuese, të cilat janë publike ose private.”*

Në nenin 21³³, të tij, përcaktohet se: *“1. Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor.*

2. Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç...”

Kopshti Ndërkulturor Shkodër, si institucion arsimor privat që operon në Republikën e Shqipërisë, është një subjekt që i nënshtrohet detyrimeve pozitive të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi, duke përfshirë, por pa u kufizuar, te kuadri ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ai për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Përkatësisht në nenin 19 të LMD-së përcaktohet se:

“...Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë:

a) rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, ndër të tjera duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm;

b) lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim brenda institucionit...”, kjo në lidhje me të gjitha karakteristikat e mbrojtura, cituar në nenin 1 të këtij ligji.

Në këtë linjë, argumenti i përdorur në parashtrimet e Kopshtit Ndërkulturor, se si institucion arsimor që operon në Republikën e Shqipërisë, me kapacitete të vogla dhe që ushtron veprimtarinë një kontekst social e mentalitet që këto tema i sheh si tabu dhe duke paraqitur se në fakt edhe pranimi dhe trajtimi i E deri para ditëlindjes së tij është “një sforcim” i institucionit”, përbën në fakt një pranim indirekt, se roli që ligji i vendos institucioneve arsimore dhe drejtuesve të tyre në Republikën e Shqipërisë për të edukuar dhe promovuar mbi barazinë dhe mosdiskriminimin për asnjë nga shkaqet e përmendura në ligj nuk është përmbushur nga Kopshti Ndërkulturor.

³¹ Kuadri rregullator dhe mbështetës i sistemit arsimor

³² Institucionet në sistemin arsimor parauniversitar

³³ Arsimi parashkollor

Në bazë të garancive kushtetuese të ofruara nga nenet 18 dhe 54, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çdo fëmijë është i barabartë përpara ligjit, nuk mund të diskriminohet pa një përligjje të arsyeshme dhe objektive dhe gëzon të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti.

Gjithashtu, në bazë të parimeve të vendosura nga ligji nr. 18/2017, përkatësisht në nenin 5, të tij, përmendet shprehimisht se fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërruar dhe progresive.

Në nenin 6, të të njëjtit ligj shtjellohet se, ndër të tjera autoritetet jopublike, siç është në rastin tonë Kopshti ndërkulturor, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijën, ku interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh ndër të tjera nevojat e fëmijës për zhvillim psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri dhe vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Në bazë të standardeve dhe parashikimeve ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve, të aplikueshme brenda sistemit juridik shqiptar, e drejta për arsim për të gjithë fëmijët, përfshirë ata që perceptohen ose identifikohen si lezbike, gej, biseksuale, transgjinorë ose interseks (LGBTI), si dhe ata që kanë prindër që identifikohen si të tillë, mbrohet në mënyrë të qartë.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), në nenin 2 të saj, parashikon se: *“1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë. 2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.”*

Në nenin 3/1, të saj, sanksionohet se: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë në qendër të vëmendjes.”*

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e*

Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS19 gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara³⁴”.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ shprehet se: “... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.³⁵”.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga (viktima e diskriminimit) te (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se trajtimi nuk ka qenë për shkakë diskriminuese...”

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë

³⁴ GjEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GjEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

³⁵ GjEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GjEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.³⁶

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i*

³⁶https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht³⁷”.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues:

Së pari, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se pala ankuese (fëmija për të cilin dhe ankohet) i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Kopshtit (drejtueses së tij)

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë dhe i pafavorshëm i fëmijës së subjektit ankues, nga ana e drejtueses së Kopshtit, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe faktet e administruara, KMD vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e Kopshtit (drejtueses së tij), kundrejt fëmijës së subjektit ankues, dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë fëmija i ankueses është diskriminuar për shkak të paragjykit të veshjes, sjelljes dhe identitetit gjinor të tij, *të perceptuar*, nga ana e drejtueses së Kopshtit, pasi rezultoi e provuar se, fëmija është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme lidhur me përjashtimin e tij de facto nga Kopshti, dhe se ky trajtim është bërë në mënyrë të pajustikuar objektivisht dhe ligjërisht.

Komisioneri thekson faktin se, identiteti dhe shprehja gjinore nuk lidhen në asnjë moment me seksualitetin e dikujt, por vetëm me perceptimin që një person ka ndaj gjinisë së tij respektive, dhe se, do të duhet që në një institucion edukimi, të gjithë fëmijëve t'u mësohej të respektonin njëri tjetrin pavarësisht karakteristikave personale dhe pamjes së jashtme, pa folur në asnjë moment për seksualitetin. Pamja e jashtme e një fëmije dhe mënyra se si zgjedh të vishet nuk ka pse të ndjekë stereotipet gjinore.

Këto paragjykime dhe stereotipe, do të ishte dashur të ishin luftuar nga një institucion edukues që prioritet duhet të ketë mirëqenien, edukimin e drejtë dhe interesin më të lartë të çdo fëmije. Në lidhje me argumentin se ky rol nuk mund të kërkohet apo të pritët të përmbushet nga një institucion i vogël edukimi që ka në target fëmijët nga 3-6 vjeç, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron dhe është haptazi i pabazuar.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës³⁸, Komisioneri vlerëson se fëmija E. H, i është nënshtruar një

³⁷ GJEDNJ, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

³⁸ Shih Ndarjen III, nëndarja A.1, të vendimit të KMD.

trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e drejtueses së Kopshtit, e cila përmes veprimeve konkludente të saj, e ka përjashtuar atë nga Kopshti, në raport me të drejtën e tij ligjore për tu trajtuar me barazi dhe mosdiskriminim.

Subjekti ankues ka pretenduar se fëmija i saj është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e drejtueses së Kopshtit.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar fakti që fëmija i ankueses e mbart shkakun e pretenduar, argumentuar në pjesën B, të Vendimit.

Posedimi i shkakut të mbrojtur nga ana e fëmijës së subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pakundërshtuar nga ana e Kopshtit, për faktin se përjashtimi i tij de facto ka ardhur përmes veprimeve konkludente të drejtueses së tij, e cila i ka bërë të qartë nënës së fëmijës se, nëse ai do vishej si zanë në festën e ditëlindjes së tij, nuk do të ishte i mirëpritur më në Kopsht.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e Kopshtit, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar të fëmijës, nga subjekti ankues, dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të padrejtë nga ana e drejtueses së Kopshtit, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që për veprimet dhe mosveprimet e drejtueses së Kopshtit kundrejt fëmijës së ankueses janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta dhe të arsyeshme, si dhe që ai të ishte trajtuar në mënyrë të drejtë e të favorshme (analizuar në pjesën e II-të të Vendimit).

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se, “pala e akuzuar”, nuk arriti të provojë me dokumentacion, fakte apo prova të tjera që fëmija i ankueses nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, lidhur me përjashtimin e tij nga Kopshti.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, është pikërisht sjellja e drejtueses së Kopshtit shkak determinant dhe i vetëm i largimit të fëmijës E. H nga Kopshti Ndërkulturor Shkodër.

Në kundërshtim me sa prezantohet dhe siç është shtjelluar gjerësisht në këtë vendim, vërtetë mungon akti formal, zyrtar i drejtueses së Kopshtit për përjashtimin e fëmijës E. H nga Kopshti Ndërkulturor Shkodër, por me veprimet e saj si titullare institucioni, (me mesazhe e komunikim telefonik me znj. H) ja ka bërë të qartë qëndrimin e saj, sa të nënkuptuar, aq dhe të drejtpërdrejtë, se, fëmija E, nuk do të ishte i mirëpritur në Kopsht, nëse do të vishej si zanë në festën e ditëlindjes së tij

Për rrjedhojë, mosdërgimi i fëmijës në Kopsht pas datës 30 janar 2025, është pasoja e ardhur si rezultat i reagimit të drejtueses së këtij institucioni.

Komisioneri vlerëson se, veprimi i nënës së E për mosdërgimin e tij në Kopsht, pas kësaj ngjarjeje, është veprimi më normal dhe i drejtë i saj, si prind dhe kujdestare ligjore e fëmijës, në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës, por edhe në mbrojtje të shëndetit mendor e mirëqenies psikologjike të tij.

Komisioneri vlerëson gjithashtu se, drejtuesja e Kopshtit nuk ka arritur të provojë se sjellja e saj në rastin konkret, është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar që garanton respektimin e të drejtave të fëmijëve për t'u trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim, si dhe mbrojtjen efektive të tyre.

Në kundërshtim me sa më sipër, drejtuesja e Kopshtit, me veprimet e saj ka synuar të “normojë”, diktojë me sjellje përjashtuese e diskriminuese, veprimet dhe sjelljen e fëmijës E, me preteksin, pretendimet e pabazuara e të keq perceptuara, se:

- Një institucion për fëmijë (3-6 vjeç) nuk është vendi i duhur për të diskutuar mbi ndryshimin e identitetit gjinor apo seksit;
- Se në institucion po ndodhte një seksualizim i fëmijëve, e se kjo temë është tabu për shoqërinë shqiptare, e se fëmija E (me veshjen e sjelljet e tij) konfuzon fëmijët e tjerë, etj.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm i fëmijës së subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, si dhe është tërësisht i papërligjur në fakte, prova e dispozita ligjore.

Gjithashtu, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka përcaktuar se diskriminimi mbi bazën e identitetit gjinor ose shprehjes gjinore është i ndaluar sipas nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 10 (liria e shprehjes).

GJEDNJ ka trajtuar raste ku ka konstatuar diskriminimin ndaj fëmijëve, për shkak të identitetit gjinor të perceptuar të tyre apo të prindërve të tyre.

Diskriminimi i bazuar në identitetin gjinor të perceptuar është i mbrojtur nga KEDNJ, në të njëjtën mënyrë, si ai mbi bazën e orinetimit seksual ose karakteristikave të tjera personale, dhe GJEDNJ, thekson me forcë se, shteti ka detyrimin pozitiv për të parandaluar dhe sanksionuar aktet e diskriminimit, veçanërisht kur ato prekin fëmijët në institucionet arsimore (qofshin ato publike apo private).

Në çështjen *Identoba and Others v. Georgia* (2015), GJEDNJ theksoi se shtetet kanë një detyrim pozitiv për të mbrojtur individët nga diskriminimi mbi bazën e identitetit gjinor.

Po ashtu, në çështjen *X v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia* (2019), rasti kishte të bënte me një fëmijë transgjinor (X), i cili u përjashtua nga shkolla pas një incidenti që lidhej me identitetin e tij gjinor. Ai ishte subjekt i trajtimit të pabarabartë, ngacmimeve dhe sjelljes

diskriminuese nga mësues dhe nxënës, ndërsa autoritetet arsimore nuk morën masa për ta mbrojtur atë.

Lidhur me rastin në fjalë, GJEDNJ, konstatoi shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 të KEDNJ (e drejta për respektim të jetës private).

Gjykata vlerësoi në këtë rast, se autoritetet arsimore kishin dështuar të mbrojnë fëmijën nga diskriminimi për shkak të identitetit të tij gjinor të perceptuar, dhe nuk kishin garantuar mbrojtje efektive të tij në një ambienti arsimor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

GJEDNJ konfirmoi se shprehja e identitetit gjinor (apo perceptimit se individi e posedon atë) është e mbrojtur nën KEDNJ dhe çdo trajtim diskriminues ndaj individëve për këtë arsye përbën shkelje të të drejtave të tyre themelore.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“ “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Përjashtimi i një fëmije nga kopshti për shkak të veshjes së tij gjatë një feste private jo vetëm që përbën një rast diskriminimi të hapur, por gjithashtu cenon të drejtën e tij për arsim dhe mirëqenie psikologjike, duke treguar se interesi më i lartë i fëmijës në këtë rast nuk është marrë në konsideratë dhe as nuk është parë me prioritet nga Drejtuesit e Kopshtit.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se drejtuesja e “Qendrës Multifunkionale Nërkturore Shkodër”, e ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, fëmijën E. H, për shkak të identitetit gjinor të perceptuar, duke sjellë për pasojë diskriminimin e tij, përse i takon përjashtimit të tij *de facto* nga Kopshti.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se fëmija i subjektit ankues, E. H, në referencë të dispozitave të posaçme të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, është ekspozuar para veprimeve diskriminuese nga ana e drejtueses së Kopshtit Ndërkulturor Shkodër.

- ***Lidhur me kërkimin tjetër të subjektit ankues, e cila përveç konstatimit të diskriminimit për shkaqet e rrethanat e parashtruara, ka kërkuar nga Komisioneri, edhe detyrimin e subjektit nga i cili vjen diskriminimi të kërkojë ndjesë, falje ndaj fëmijës E dhe nënës së tij.***

Këtë kërkim, Komisioneri nuk e vlerëson si adekuat dhe efektiv, pasi nuk ndikon në rivendosjen e së drejtës, duke gjykuar se, përfshirja e mëtejshme e fëmijës në vazhdimin e situatës (qoftë dhe

duke i kërkuar ndjesë) është e tepërt dhe situatë rënduese për të (bazuar dhe në vlerësimin e psikologes, e cila ka sugjeruar që të mos i jepet shumë rëndësi situatavë të krijuara për shkakun e elaboruar).

Në parim, Komisioneri vendos për detyrimin e kërkim faljes, ndjesës, kur subjekti që ka konsumuar veprimet a sjelljen diskriminuese, ka përdorur gjuhë fyese, përçarëse, urrejtjeje, publikisht në media elektronike apo të shkruara, në televizione apo rrjete sociale, pasi në këto raste, ndjesa e kërkim falja, kanë efekt si ndaj personit apo grupit të personave të diskriminuar, ashtu dhe ndaj publikut që e ka ndjekur në mediat a plaformat përkatëse.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të fëmijës E. H, për shkak të identitetit gjinor të perceptuar të tij, nga ana e drejtueses së “Qendrës Multifunkionale Nërkulturore Shkodër”, znj. K. K, lidhur me përjashtimin e tij nga Kopshti.
2. “Qendra Multifunkionale Nërkulturore Shkodër”, të parashikojë në Rregulloren e Brendshme të saj, të drejtën për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të fëmijëve, sipas ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.
3. “Qendra Multifunkionale Nërkulturore Shkodër”, të marrë masa për trajnimin e stafit për respektimin e të drejtave themelore të fëmijëve, trajtimin gjithëpërfshirës të tyre sipas standardeve të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, “Qendra Multifunkionale Nërkulturore Shkodër”, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për sa më sipër.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI
Robert GAJDA